**20262524591**

## АГЕНЦИЈА ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ОДЗЕМЕН ИМОТ

Drejtues i Agjencisë për menaxhim me pronën të konfiskuar në mbledhjen e 13-të me radhë për vitin 2026, të mbajtur më datë 22.10.2026, miratoi këtë:

### RR E G U LL O R E
### PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË LEGJITIMITETIT ZYRTARE, MËNYRËN E LËSHIMIT DHE MARRJES SË TIJ PËR PUNONJËSIT NË AGJENCINË PËR MENAXHIM ME PRONËN TË KONFISKUAR

Neni 1

Me këtë Rregullore ndryshohet Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimitetit zyrtare, mënyrën e lëshimit dhe marrjes së tij për punonjësit në Agjencinë për menaxhim me pronën të konfiskuar nr. 01-721/1 e datës 7 shkurt 2025, e publikuar në („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 50/25), Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimitetit zyrtare, mënyrën e lëshimit dhe marrjes së tij për punonjësit në Agjencinë për menaxhim me pronën të konfiskuar nr. 01-2427/8 e datës 28 maj 2025, e publikuar në („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 121/25) dhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimitetit zyrtare, mënyrën e lëshimit dhe marrjes së tij për punonjësit në Agjencinë për menaxhim me pronën të konfiskuar nr. 01-1955/1 e datës 22 prill 2026, e publikuar në („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 89/26), edhe atë në nenin 5 fjalët: „Sektori për menaxhim me resurset njerëzore“, zëvendësohen me fjalët: „Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar, zhvillim strategjik dhe resurse njerëzore“.

Neni 2

Në nenin 7 në paragrafin 2 fjalët: „Sektori për menaxhim me resurset njerëzore“, zëvendësohen me fjalët: „Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar, zhvillim strategjik dhe resurse njerëzore“.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Pas hyrjes në fuqi, kjo rregullore do të publikohet edhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Agjencia për Menaxhimin e
Pronës së Konfiskuar
Këshilli Drejtues
Kryetari,
**Станко Китаноски,** d.v.

Nr. 01-5185/1
22.10.2026
Shkup